

#2223
Kthimi sërish te bazat
2 e Pjetrit 1:1–21

Ju ftoj tani të merrni Biblat tuaja dhe të shkojmë së bashku te 2 e Pjetrit. Te Letra e Dytë e Pjetrit, dhe sipas fletës që më kanë dhënë, tani kemi arritur në pikën ku duhet të kemi një shtjellim të hapur. Prandaj do të provojmë ta bëjmë këtë me ndihmën e Perëndisë.

Më lejoni ta lexoj:

“Simon Pjetri, shërbëtor dhe apostull i Jezu Krishtit,

atyre që kanë marrë një besim të barsvlershëm me tonin, me anë të drejtësisë së Perëndisë tonë dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht: hir dhe paqe ju shtoftë në njohjen e Perëndisë dhe të Jezusit, Zotit tonë. Duke qenë se fuqia e tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë, me anë të njohjes së atij që na thirri përmes lavdisë dhe virtytit, me anë të të cilave na u dhuruan premtimet shumë të mëdha e të çmueshme, që nëpërmjet tyre të bëheni pjesëtarë të natyrës hyjnore, pasi u arratisët nga prishja që është në botë për shkak të epshit; edhe për këtë arsye, duke treguar çdo zell, t’i shtoni besimit tuaj virtytin, dhe në virtyt njohurinë, dhe në njohuri përmbajtjen dhe në përmbajtje durimin, dhe në durim perëndishmërinë, dhe në perëndishmëri dashurinë vëllazërore dhe në dashurinë vëllazërore dashurinë. Sepse, nëse këto gjëra gjenden në ju dhe shtohen, nuk do t’ju lejojnë të bëheni përtacë dhe as të pafryt në njohjen e Zotit tonë Jezu Krisht. Sepse ai, që nuk i ka këto gjëra, është i verbër dhe dritëshkurtër, dhe ka harruar pastrimin nga mëkatet e tij të vjetra.

Prandaj, vëllezër, jini të zellshëm aq më shumë ta përforconi thirrjen dhe zgjedhjen tuaj, sepse, duke bërë këto gjëra, nuk do të pengoheni kurrë. Sepse kështu do t’ju jepet të hyni begatisht në mbretërinë e përjetshme të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.

Prandaj nuk do të lë pas dore t'ju kujtoj gjithnjë këto gjëra, ndonëse ju i dini dhe jeni të forcuar në këtë të vërtetë. Por unë mendoj se është e drejtë, përderisa jam në këtë tendë, t'ju mbaj zgjuar duke jua sjellë këto gjëra ndër mend, duke ditur se, së shpejti do të lë këtë tendën time, sikurse edhe ma tregoi Zoti ynë Jezu Krisht. Por do të jem i zellshëm që, edhe pas largimit tim, ju të mund t'i kujtoni gjithnjë këto gjëra.

Sepse nuk jua bëmë të njohur fuqinë dhe ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht, duke ndjekur përralla të sajuara me mjeshtëri, por u bëmë dëshmitarë okularë të madhështisë së tij. Sepse ai mori nder dhe lavdi nga Perëndia Atë, kur i erdhi një zë i tillë nga lavdia e madhërishme: 'Ky është Biri im i dashur, në të cilin unë gjeta pëlqim.' Dhe ne e dëgjuam këtë zë që vinte nga qielli, kur qemë bashkë me të në malin e shenjtë.

Ne e kemi edhe më të përforcuar fjalën profetike, së cilës bëni mirë t'i kushtoni kujdes, si një kandil që ndriçon në një vend të errët, derisa të zbardhë dita dhe ylli i mëngjesit të lindë në zemrat tuaja, duke ditur, së pari, këtë: që asnjë profeci e Shkrimit nuk është objekt i shtjellimeve të veçanta. Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur ndonjëherë nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë.”

Atë, ne lutemi që ndërsa mblidhemi në praninë tënde dhe me Biblat tona të hapura para teje, të kërkojmë që, nga bollëku i dashurisë sate të pamasë, duke qenë se ti kënaqesh kur u jep dhurata të mira fëmijëve të tu, të na japësh ndjesinë e mahnitjes me të vërtetën tënde, që të tërhiqemi sërish te Biri yt, në emrin e të cilit ne të lutemi. Amen.

Kam zgjedhur që këto ditë të filloj në këtë pasazh për disa arsye. E para, për t'u treguar vërtet i sinqertë me ju, është ngaqë këto muajt e fundit më është dashur ta studioj 2 e Pjetrit, dhe më është dukur shumë e vështirë. Prandaj vendosa që t'i bëj edhe të tjerët të vuajnë bashkë me

mua—ose të përfitojnë nga urtësia që Perëndia do të na japë. Një arsye tjetër është ngaqë njerëz të ndryshëm më bëjnë vazhdimisht pyetjen: “Çfarë do të ndodhë në konferencën e pastorëve?”. Në ato raste jam përgjigjur: “E po, do të trajtojmë disa nga bazat.” “Oh, mirë!”, thonë ata, “a nuk e bëmë këtë vitin e kaluar?” Unë u them: “E po, po, *i bëmë* bazat vitin e kaluar, prandaj do t’i bëjmë sërish bazat këtë vit.” Shumë prej tyre nuk i kushtojnë rëndësi dhe thonë: “E po, shpresoj të kalosh një kohë të mrekullueshme. Sigurisht që unë nuk do të vij, por faleminderit që më tregove”, kështu ata thjesht largohen. Edhe unë largohesha duke thënë me vete: “Mos vallë e kemi nisur keq?”. Dua të them, a është kaq e rëndësishme që të kthehemi te ky material bazë?

Prandaj mora Fjalorin Anglisht të Oksfordit (*Oxford English Dictionary*) dhe po shikoja fjalën “bazë”, për të zbuluar saktësisht se çfarë gjëje po i referoheshim kur po flisnim për bazat. Atje thuhet se fjala *bazë*, në thelb, është ajo që i përket apo formon një bazë, diçka themelore, një gjë thelbësore; ajo që përbën minimumin apo një shkallë standarde. Prandaj thashë: “Po, kjo është shumë e saktë. Mendoj se kjo është ajo që duam të bëjmë.” Kur shkova sërish te Shkrimet, për të parë mënyrën se si vetë apostujt përpiqen të sigurohen se ata të cilëve po u shkruajnë, të mbërthehen dhe të marrin përkujdesje nga e vërteta që ata u transmetojnë, nuk është e pazakontë—në fakt, është mjaft e shpeshtë—të zbulosh se ajo që ata po bëjnë, është që thjesht po i çojnë lexuesit e tyre sërish nëpër shtigje të sprovuara, në mënyrë që marrësit e letrave të tyre të mund të themelohen në të vërtetën thelbësore. Duke qenë se jemi të privilegjuar që kemi mundësinë e përpjekjes për t’i themeluar bashkësitë tona në të vërtetën e Biblës dhe në veprën e Krishtit, mendova se ndoshta do të ishte mirë që të kalonim pak më shumë kohë për t’u siguruar që ne vetë të mos dalim nga binarët. Dhe sigurisht, mënyra se si mund ta bëjmë këtë, është duke parë sërish atë që është themelore dhe thelbësore.

Kujtesa ka rëndësi

Për këtë arsye, dua të filloj me paragrafin që nis në vargun 12, ku Pjetri nuk ka fare turp t'u thotë lexuesve të tij që kujtesa ka rëndësi. Kujtesa ka rëndësi. Nëse dëshiron të kesh çelësin për ta kuptuar 2 e Pjetrit, jam i sigurt që ai është në këtë paragraf. Të kuptuarit e përmbajtjes dhe strukturës së letrës nuk ka dyshim që qartësohet në mënyrë edhe më të efektshme sapo të kemi kapur theksimin e Pjetrit në këto pak vargje.

Në vargun 12, ai thotë: “Prandaj nuk do të lë pas dore t’ju kujtoj gjithnjë këto gjëra.” Në vargun 13 thotë: “...mendoj se është e drejtë... t’ju mbaj zgjuar duke jua sjellë këto gjëra ndër mend.” Prandaj, duke u përpjekur që t’i ruajë lexuesit e tij dhe pastaj t’i bëjë të jenë vigjilentë, apostulli po u kujton atyre të vërtetat, të cilat janë bazat e domosdoshme për qëndrueshmëri dhe pjekuri. Ai u thotë: “Nëse doni të jeni të qëndrueshëm dhe nëse doni të vazhdoni të piqeni, atëherë duhet t’i kushtoni vëmendje shumë të thellë informacionit të cilin, sinqerisht, e di që nuk është i panjohur për ju.” Do të vini re që ai nuk justifikohet fare që u shkroi për t’i kujtuar.

Ajo që Pjetri po siguron për lexuesit e tij, mund të themi që është një dozë e rëndësishme ilaçi frymëror. Dikush më tha dje se sasia e parave që shpenzohet për kujdesin shëndetësor në Shtetet e Bashkuara, të paktën vitin e kaluar, ishte 1.3 trilion dollarë. Për këtë arsye, shumë prej atyre që punojnë në industrinë e shëndetit, janë shumë të interesuar të zbulojnë nëse mund t’i kushtojnë më tepër vëmendje fazës së parandalimit, në vend që të merren me sëmundjet, pasi ato të jenë përhapur. Sigurisht që këtu ka një urtësi të madhe. E po, në të njëjtën mënyrë, ata që janë përgjegjës për kujdesin frymëror të shpirtave të tjerëve, mësojnë nga Pjetri, duke u përpjekur të sigurojnë ilaçe parandaluese për ata që janë nën kujdesin e tyre.

Sigurisht, shqetësimi i Pjetrit është që lexuesit të mos tërhiqen nga zërat shpërqendruar të herezisë shkatërrimtare në atmosferën përreth tyre. Nëse e keni Biblën të hapur, do ta vini re këtë

gjë në vargun e parë të kapitullit 2: “profetët e rremë”, “mësuesit e rremë”, “do të fusin fshehurazi herezi shkatërruese dhe, duke mohuar Zotërinë që i bleu ata, do të tërheqin mbi vete një shkatërrim të shpejtë.”¹ Ai thotë: “Për mua është e rëndësishme të sigurohem që ju jeni mbërthyer nga këto gjëra thelbësore dhe po i rrokni ato.”

Nuk duhet të na shpëtojë pika e qartë e zbatimit, për faktin që ai po jep një shembull për të gjithë ata, të cilëve u është besuar kujdesi për shpirtrat. Çfarëdo lloj përgjegjësie tjetër që kemi, ne jemi burra të veçuar nga Perëndia për t’u kujdesur për shpirtrat e njerëzve. Kjo gjë duhet të na mbajë zgjuar natën. Kjo duhet të na bëjë të zgjohemi në mëngjes dhe të hidhemi në veprim—nga njëra anë, nuk duhet të largohemi nga kjo përgjegjësi e mahnitshme, dhe nga ana tjetër, duke qenë se jemi pajisur nga Perëndia, të mund të ecim përpara në këtë privilegj të jashtëzakonshëm. Pavarësisht gjithë trysnisë së tanishme, si në qarqet e arsimimit normal, ashtu edhe në sferën e edukimit biblik, Pjetri po thotë se është shumë e rëndësishme që të sigurohemi se nuk po i lëmë në baltë ata që janë nën kujdesin tonë, duke harruar që t’u kujtojmë gjërat thelbësore.

Dikush më dha një libër për tramvajet e Glasgow-t. Bashkia i nxori jashtë përdorimit tramvajet në Glasgow kur unë isha afërsisht gjashtë vjeç, pothuaj dyzet vjet më parë—e nxorën jashtë përdorimit rrjetin e tramvajit në zonën qendrore dhe në rrethinat e Glasgow-t. Tani, dikush—një gjeni—ka sugjeruar që mënyra se si duhen trajtuar problemet e trafikut në Glasgow, është duke e rikthyer sistemin e tramvajit, dhe me sa duket, po presin që të vdesin të gjithë ata të cilët punonin me sistemin e vjetër të tramvajit, që të mos turpërohen dhe aq shumë për sugjerimin e kësaj ideje. Gjithsesi, libri për tramvajet është një libër i vogël dhe shumë interesant. Personi që ma dha librin si dhuratë, kishte shkruar në të këtë dedikim: “Të të kujtoj që

¹ 2 e Pjetrit 2:1.

të mos harrosh kurrë.” “Të të kujtoj që të mos harrosh kurrë.” E kuptova se çfarë po më thoshte. “Është e rëndësishme”, po më thoshte ky person, “që të mos i harrosh rrënjët e tua, që të mos harrosh se nga erdhe, sepse *nëse* e humbet bazën *tëndë*, atëherë do të jesh bezdi për ata që janë nën ndikimin tënd.”

Prandaj, kjo është, më së pari, një thirrje për ne që kemi përgjegjësi pastorale, që të sigurohemi se jemi të stabilizuar dhe se po vazhdojmë të piqemi, në mënyrë që edhe ne të bëjmë të njëjtën gjë si Pjetri. Fakti që Pjetri tregon njëfarë urgjence, është i qartë për ne nga ajo që ai thotë në vargun 14: “duke ditur se, së shpejti do të lë këtë tendën time, sikurse edhe ma tregoi Zoti ynë Jezu Krisht.” Prandaj, ai po shfrytëzon çdo mundësi, që pas largimit të tij, njerëzit të jenë në gjendje të kujtojnë atë që ai u mësoi.

Të njëjtën gjë e dëgjoni edhe në fjalët e fundit të Palit te 2 e Timoteut, apo jo? Ai thotë të njëjtën gjë. “Koha e nisjes sime arriti”,² “koha e *largimit*.” “Po shkoj në shtëpi”, thotë ai. “Prandaj, Timote, dua që ti të mbash mend.” Baza më thelbësore e asaj që Pali do që Timoteu të kujtojë, është te 2 e Timoteut 2:8, ku ai i thotë: “Kujto Jezu Krishtin.” A të duhet t’i shkruash një pastori dhe t’i thuash që të kujtojë Jezu Krishtin? Po! Sepse pastori mund të ketë dalë rreth lagjes, duke i kujtuar vetes programin e tij në internet, strategjitë e ungjillëzimit, përgjegjësitë e tij në natyrën e udhëheqjes, dhe, në fakt, krejt pa dashje mund të ketë filluar ta harrojë Jezusin. Prandaj, ju thoni: “E po, nëse Pali, apostulli i madh i dërgon një letër të fundit këtij udhëheqësi të ri dhe i thotë: ‘Kujto Jezu Krishtin’, atëherë, cili nga ne do të thotë sot: ‘E po, këtë e ke kapur. Kujtojua atyre këto gjëra.’” Po ne? Po ne, a e kemi kapur? Dhe *pastaj*, në vargun 14 të të njëjtë kapitull, 2 e Timoteut 2, ai thotë: “Ua kujto atyre këto gjëra.” Së pari, kujto ti vetë, dhe pastaj kujtojua atyre. Rrjedhoja këtu është që, nëse pastori harron, bashkësia e ka humbur fare. Natyra e

² 2 e Timoteut 4:6.

zbrazët e një pjese të madhe të prezantimit biblik—dhe për këtë nuk ka nevojë të shohim përtej vetes—është e lidhur drejtpërdrejt me mundësinë e qartë që ne, si barinj të shpirtave, kemi harruar se çfarë po i nxitim të tjerët që të kujtojnë.

Peterson-i, në parafrazimin e tij të Biblës në versionin *The Message*, na e jep kuptimin e kësaj në një mënyrë shumë të dashur. Duke i parafrazuar fjalët e Pjetrit siç i gjejmë këtu, ai thotë: “Edhe pse e njihni shumë mirë këtë të vërtetë dhe madje e praktikoni fill e për pe, nuk do të rri rehat as për një çast që t’ju kujtoj t’i kushtoni vëmendje... e di që shumë shpejt do të vdes... prandaj jam shumë i zellshëm që t’i keni këto gjëra të shkruara të zezë mbi të bardhë, që pasi të kem vdekur, ta keni në duart tuaja.”³ Kjo është vërtet e mirë, apo jo? Do të doja që edhe unë të kisha mundësi të shkruaja një parafrazim si ky. Nuk e di për ju, por unë nuk do të mundesha, edhe po të më jepnit një pasdite të tërë.

E shihni që, të gjithë mësuesit i lënë pashmangshmërisht shenjat e tyre në foltore. Ju dhe unë po i lëmë shenjat tona te studentët tanë—për mirë apo për keq. Nëse e kemi kthyer mësimin tonë në një formë harrimi të Krishtit, mund të kemi përfunduar në një formë moralizmi, sa që jemi bërë krejt të pavëmendshëm ndaj vetes—që, në fakt, po i nxitim njerëzit tanë drejt një stili jete dhe drejt një modeli ekzistence, por ne vetë jemi të paankoruar, jemi të zgjidhur nga Krishti, i cili është “gjithçka dhe në të gjithë”⁴. Prandaj, Pjetri thotë: “Nuk do t’ju kërkoj ndjesë për faktin që, edhe pse ju i kuptoni këto gjëra, unë sërish do t’jua kujtoj.”

Tani, disa prej jush që më kanë dëgjuar të flas, e dinë që nuk mund ta kaloj dot këtë pjesë të vogël pa ju treguar për mësuesin tim të historisë në Yorkshire, Angli, kur unë isha gjashtëmbëdhjetë apo shtatëmbëdhjetë vjeç. Ai ishte një burrë shumë krenar nga Yorkshire, ishte

³ 2 e Pjetrit 1:12–15 (MSG).

⁴ Kolosianëve 3:11.

krenar për qytetin nga vinte—domethënë, për Bradford-in. Ndërsa ai mundohej të na mësonte historinë e botës dhe sidomos historinë e hershme të Britanisë së Madhe, herë pas here ndalonte dhe thoshte: “Tani, dëgjoni këtu. Nuk ka rëndësi se çfarë harroni nga lënda ime, ama këtë mos e harroni kurrë: Mos e harroni kurrë që Bradford City fitoi kupën e futbollit në vitin 1911.” Kjo është një lloj sikur mësuesi juaj i historisë t’ju thoshte se ekipi “Cleveland Indians” fitoi Kupën e Botës në bejsboll. Rezultati është që, pas tridhjetë e pesë vjetësh, e vetmja gjë që mbaj mend nga klasa e tij, është kjo që ju thashë. Nuk mbaj mend asgjë tjetër që më mësoi ai. Ama këtë nuk e kam harruar kurrë! Ai më tha që të mos e harroja, prandaj nuk e harrova! Nëse do të ma kishte shpjeguar këtë në lidhje me Betejën e Hastings-it, mund të kisha qenë një historian shumë inteligjent. Mirëpo, gjithë sa më ka mbetur është një fakt i vetëm nga gjithë historia angleze—pra, viti kur Bradford City fitoi kupën e futbollit.

Elementi që përsëritet në këtë pasazh—i cili duket shumë qartë, vargu 12, “nuk do të lë pas dore t’ju kujtoj gjithnjë”—është i qëllimshëm. Pse do t’ju kujtoj gjithmonë? Pse kemi nevojë të kthehemi vazhdimisht te bazat? Për të njëjtën arsye që e bën edhe nëna me fëmijët e saj. A nuk është një nga deklaratat e mëdha të nënave: “Sa herë më duhet që të ta them? Nëse ta kam thënë një herë, ta kam thënë njëqind herë”? Dhe sigurisht që Jezusi bëri të njëjtën gjë: “Ka kaç kohë që kam qenë me ju, dhe ju ende nuk më kuptoni?”⁵ Sa herë duhet t’jua them të njëjtën gjë, juve nxënës që nuk nxini? Duhet të shkoj në Jerusalem dhe të vuaj në duart e njerëzve mizorë, të vdes dhe të ringjallem”,⁶ dhe ata të gjithë vijnë rreth tij dhe thonë: “Oh, jo, jo, jo, jo, jo, nuk ka mundësi!”. Jezusi u thotë: “Më duhet t’jua them të njëjtën gjë vazhdimisht.”

⁵ Gjoni 14:9 (parafrazim).

⁶ Shih, për shembull, Mateu 16:21.

Në fakt, kjo më jep shumë siguri. Sepse, nëse vetë Zotit të mishëruar të lavdisë, me gjithë fuqinë dhe aftësinë e tij, në ndërveprimin e tij të përditshëm me dymbëdhjetë burra, i duhet të thotë: “A duhet që t’u kthehem sërish bazave me ju?”, atëherë, a ju duket e habitshme që në shërbesën tonë pastorale, bëjmë mirë t’i kushtojmë vëmendje *të veçantë*, të sigurohemi që nuk po biem pre e idesë se ajo për të cilën kanë nevojë bashkësitë tona, është ndonjë udhëtim në botën e çudirave, apo jo? A thua se kemi nevojë për një udhëtim në ndonjë park argëtimi frymëror. A thua se kemi nevojë të prezantohemi me idenë më të re sekrete të trumbetuar nga mediat e krishtera bashkëkohore. Ai u tha: “Unë do t’jua kujtoj këto gjëra.”

Duke komentuar mbi këto fjalë, Christopher Green-i tha se “frika e Pjetrit nuk ishte që brezi [tjetër] do ta kthente në dogmë të vërtetën e fosilizuar, por që ata do të ishin aq të shkujdesur në lidhje me të vërtetën, sa që do ta harronin atë krejtësisht.”⁷ Zotërinj, nëse ky ishte shqetësimi i Pjetrit në shekullin e *parë*, a nuk është ky një shqetësim për ne në shekullin e njëzetë? Rreziku i madh nuk është dogmatizimi dhe fosilizimi i së vërtetës nga ana e bashkësive tona; rreziku i madh është që bashkësitë tona do të bëhen krejtësisht të shkëputura prej saj.

Pjetri ishte një jude i mirë dhe e kuptonte që Perëndia kishte dhënë tregues gjatë historisë, si shenja rikujtimi. Në festën e Pashkës, ai u thotë: “Dua që të më kujtoni mua. Dua që të kujtoni se ishit skllëvër në Egjipt. Prandaj festoni Pashkën”, Ligji i Përtërirë 16, “me qëllim që ta kujtosh ditën që dole nga Egjipti tërë ditët e jetës sate.”⁸ Ligji i Përtërirë 5:15: “Mos harro që ke qenë skllav në vendin e Egjiptit.” Përse shërbenin gurët që u ngritën në këmbë te Jozueu 4? Në shenjë kujtimi! Shpjegimi është dhënë: “Kur në të ardhmen bijtë tuaj do t’i pyesin etërit e tyre duke thënë: ‘Ç’janë këta gurë?’, ju do t’u bëni të ditur bijve tuaj, duke thënë: ‘Izraeli e kaloi këtë

⁷ Dick Lucas dhe Christopher Green, *The Message of 2 Peter and Jude: The Promise of His Calling*, The Bible Speaks Today (Downers Grove, IL: IVP Academic, 1995), 67.

⁸ Ligji i Përtërirë 16:3.

Jordan në të thatë.”⁹ “Por kujto Krijuesin tënd në ditët e rinisë sate.”¹⁰ “Kujto Jezu Krishtin, prej farës së Davidit, të ngjallur prej së vdekurish.”¹¹ “Bëni këtë në përkujtimin tim.”¹²

Ma trego shpesh historinë,
Sepse shumë shpejt e harroj;
Se vesën e mëngjesit
Dielli i mesditës e largoi.¹³

A po ua tregojmë historinë bashkësive tona? A po e predikojmë kryqin e Zotit Jezu Krisht? A po e mbajmë mend atë që është themelore për nxitjen e zemrave tona dhe ecjes sonë me Perëndinë? Kjo është sfidë shumë e madhe; kështu është për mua.

Sigurisht që populli jude është shumë i zoti në këtë pikë. *Violinisti mbi çati (Fiddler on the Roof)*—më pëlqen shumë filmi *Violinisti mbi çati*. Po juve? Ju thoni: “Ka kohë që nuk kemi luajtur mbi çati.” Jo, dhe ju sugjeroj që të mos e bëni. Mirëpo, sigurisht që violinisti mbi çati, bëri një melodi të vogël, që Tevja të mund të shpallte deklaratat e tij filozofike. Ndërsa ai këndon këngën “Tradita”, ndalon në intervale të caktuara dhe bën disa deklarata të përmbledhura, dhe në një pikë të caktuar, ai thotë: “Tradita, ajo na mëson se kush jemi dhe se çfarë pret Perëndia nga ne.”¹⁴ Rreziku mes popullit të Perëndisë është që ne e kemi harruar identitetin tonë në Krishtin, dhe për pasojë, e kemi harruar atë që Perëndia synon për ne, duke qenë se jemi vendosur në Krishtin. Pjetri e kupton këtë dhe prandaj thotë: “Ja pse dua të sigurohem që ju t’i mbani mend këto gjëra.”

⁹ Jozueu 4:21–22.

¹⁰ Predikuesi 12:1.

¹¹ 2 e Timoteut 2:8.

¹² Luka 22:19. Shih gjithashtu 1 e Korintasve 11:24.

¹³ A. Katherine Hankey, “Tell Me the Old, Old Story” (1866).

¹⁴ *Fiddler on the Roof*, drejtuar nga Norman Jewison-i, Beverly Hills, CA: United Artists, 1971 (parafrazim).

Martyn Lloyd-Jones-i e trajton këtë gjë në një libër të vogël dhe të mrekullueshëm për 2 e Pjetrit, dhe thotë: “Puna e kishës dhe e predikimit nuk është që të na japë neve ide të reja dhe interesante, përkundrazi, ka për qëllim që të na kujtojë disa të vërteta themelore dhe të përhershme.”¹⁵ Këtë nuk do t’jua them përsëri, prandaj dua që të mbani mend, si një pusullë në mendjen tuaj. Ju thoni: “Kësaj dua t’i kthehem sërish sot, ose në mbrëmje kur të jem duke i dhënë makinës, ose kur të jem duke menduar. Sepse dua t’i bëj vetes pyetjen: ‘A e besoj këtë?’”. “Puna e kishës dhe e predikimit nuk është që të na japë ide të reja dhe interesante, përkundrazi, ka për qëllim që të na kujtojë disa të vërteta themelore dhe të përhershme.”

Arsyeja pse them se bëjmë mirë që ta pyesim veten nëse e besojmë këtë, është sepse shumë nuk e besojnë! Pasi po ta besonin, do të bëhej e dukshme në predikimin dhe mësimdhënien e tyre. Në mundësitë e pakta që kam për të kaluar nga një seminar teologjik te tjetri, kam zbuluar që njerëzit në fakultetin e Biblës, kur më ftojnë zakonisht për ndonjë drekë, përpiqen të kuptojnë se çfarë mendoj unë—kjo zgjat afërsisht pesëmbëdhjetë sekonda, dhe pastaj flasim për gjëra të tjera—por kur hamë drekë bashkë, ka një pyetje të cilën ma bëjnë çdo herë. Nuk po talle... ky është *fakt*. Në çdo rast, pa përjashtim më pyesin: “Pasi jemi munduar t’u mësojmë studentëve tanë të kenë një zotërim të mirë të teologjisë biblike, që t’u ushqejmë atyre një dashuri të vërtetë për Fjalën e Perëndisë dhe një bindje të vërtetë për mjaftueshmërinë e saj—si mund të sigurohemi që, gjashtë javë pas diplomimit të tyre, ata të mos vrapojnë pas çdo ideje të re? Si është e mundur që ata kapitullojnë kaq shpejt para frymës së epokës?”.

Kësaj mund t’i kthehem; do ta lë në formën e një pyetjeje retorike. Ama, kjo është një pyetje shumë e rëndësishme, apo jo? Një pjesë e përgjigjes vjen si rezultat i bindjeve që kanë djemtë e rinj; ata nuk kanë një bindje për vetë Fjalën e Perëndisë. Prandaj, nga dëshira për të

¹⁵ D. M. Lloyd-Jones, *Expository Sermons on 2 Peter* (Edinburgh: Banner of Truth, 1983), 56.

qenë të suksesshëm, e cila lidhet direkt me rritjen numerike, ata shohin përreth vendit dhe zbulojnë se kush ka sukses nga ana numerike. Pastaj, në varësi të fuqisë së suksesit numerik, ata shkojnë dhe zbulojnë se mbi çfarë strategjie po funksionojnë, dhe kështu përpiqen ta bëjnë atë strategji të tyre dhe ta zbatojnë në kontekstin e tyre. Çfarëdo që mund të thoni për këtë, ajo që ndodh në njëfarë mase është që, autoriteti dhe mjaftueshmëria e Fjalës së Perëndisë po dobësohet. Mund të duhet një brez, që ky dobësim të bëhet i dukshëm, por ama *do të* bëhet i dukshëm.

Një besim i përbashkët

Do ishte një pasdite vërtet e gjatë nëse do të kaloja me hollësi përmes këtij kapitulli, por nuk do ta bëj. *Mund* ta bëja, por nuk mendoj se do të më falënderonit. Prandaj, ajo që dua të bëj, është që thjesht t'ju jap skicën time, dhe pastaj ju mund ta plotësoni vetë. Në fakt, kjo skicë mund të mos ju duket shumë e dobishme, dhe në këtë rast do t'ju nxisë që të bëni një skicë më të mirë për kapitullin 1 te 2 e Pjetrit.

Arsyeja pse fillova në mes të kapitullit është ngaqë mendoj se mesi është vendi ku duhet filluar—njëlloj si në rastin kur lexoni një letër nga dikush; fillimi i letrës nuk është domosdoshmërisht pjesa ku trajtohet çështja kryesore; çelësi që ju ndihmon të kuptoni hyrjen dhe përfundimin, nuk është domosdoshmërisht në fillim të letrës. Këtë e kuptoni; e kuptojmë të gjithë.

Mirëpo, në vargun 1 dhe 2, Pjetri flet për këtë besim të çmuar. Ai dëshiron t'u kujtojë lexuesve të letrës së tij faktin se ajo që i bashkon ata, nuk është një interesim i përbashkët për problemet e botës, nuk është një interesim i përbashkët për përndjekjen e asaj kohe, nuk është një kundërshtim i përbashkët ndaj gënjeshtres që ishte kudo rreth tyre—gjë të cilën ai do ta trajtojë

në kapitullin 2—por ajo që i bashkon, është një besim i përbashkët. Një besim i përbashkët. Këta individë “atyre që kanë marrë një besim të barasvlershëm me tonin, me anë të drejtësisë së Perëndisë tonë dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.”

Meqë ra fjala, a nuk është vërtet e mrekullueshme që Simon Pjetri, i cili pa dyshim që ishte një tip shumë impulsiv, tani e prezanton veten, së pari, si shërbëtor dhe pastaj si apostull? Ai mund të kishte thënë “apostull” dhe pastaj “shërbëtor”: “Përshëndetje, unë jam Pjetri. Unë po ju shkruaj, unë apostulli i fuqishëm po ju shkruaj juve.” Në fakt, ai thotë: “Unë jam Pjetri. Unë jam një shërbëtor. Unë jam një *doulos*, unë jam një skllav, unë jam një shërbëtor i Jezu Krishtit. Unë gjithashtu kam edhe privilegjin të jem një apostull.” Me fjalë të tjera, më së pari, ai prezanton marrëdhënien e tij para se të flasë për pozitën e tij. Një nga arsyet pse disa prej nesh rrëzohen aq keq, është ngaqë kërkojnë pozitën dhe nuk ia dalin kurrë të themelojnë ndonjë marrëdhënie domethënëse. Po flas, më së pari, për veten.

Ai thotë: “Burra dhe gra, gjëja e mrekullueshme është që hiri i Perëndisë na ka dhënë një drejtësi.” Kur e studioni këtë fjalë, do t’ju duhet të përlësheni me pyetjen nëse fraza e përdorur prej tij, “drejtësisë së Perëndisë tonë dhe të Shpëtimtarit tonë”, është një referencë për paanësinë e Perëndisë—me fjalë të tjera, të vepruarit në mënyrën e duhur, duke mos qenë diskriminues në shpërndarjen e hirit të tij—apo nëse ajo që ai po trajton këtu, është ideja e drejtësisë së Krishtit që na llogaritet neve, e cila sigurisht që është domosdoshmëria themelore, që ne të vendosemi në një pozitë të drejtë me Perëndinë. Sa më shumë që e kam studiuar këtë pjesë, aq më të vështirë e kam pasur që të dal në një përfundim. Prandaj vendosa që ndoshta Pjetri dëshironte që ne t’i kishim të dyja këto mendime në mendje; që Perëndia, me anë të drejtësisë së tij, ka vepruar me paanshmëri, dhe se mbi bazën e drejtësisë së Krishtit, e cila na llogaritet neve, ne jemi sjellë në këtë besim të çmuar dhe të përbashkët.

Për këtë arsye, ai u ofron atyre “hir dhe paqe”, sepse kjo është ajo për të cilën ata kanë me të vërtetë nevojë. Hiri i pari, dhe pastaj paqja. Ndoshta ky është shkaku dhe pasoja; nuk e di. Sigurisht që, të drejtësuar me anë të besimit, ne kemi paqe me Perëndinë.¹⁶ Ai u thotë: “Dua që të njihni hir dhe paqe.” Këto gjëra nuk do të shijohen në boshllëk; kjo vjen me anë të njohjes së Zotit Jezus: “në njohjen e Perëndisë dhe të Jezusit, Zotit tonë.” Fjala që përdoret këtu, është *epignosis*, njohja e Perëndisë, gjë e cila është dhuratë e hirit të tij falas, me anë të së cilës, burrat dhe gratë dallohen si besimtarë të vërtetë. Ai e bën të qartë këtë pikë themelore, sepse përmes kësaj njohurie që na jepet, ne duhet të vazhdojmë dhe t’ia shtojmë këtë njohje përvojës sonë, përmes studimit të zellshëm dhe zbatimit të kujdesshëm.

“Premtime shumë të çmuara”

Ai, pra, thotë: “Ju duhet ta kuptoni që ne kemi një besim të çmuar.” Pastaj, në vargun 3 dhe 4, ai thotë: “Dua që të vini re se ne kemi disa premtime shumë të mëdha dhe të çmueshme”: vargu 4 thotë: “me anë të të cilave na u dhuruan premtimet shumë të mëdha e të çmueshme.”

Vini re sërish që, në vargun 3, Pjetri përdor fjalën “njohje”. Kjo është një fjalë shumë e rëndësishme, pasi shumë prej mësuesve të rremë po thoshin: “Ne mund t’ju japim njohuri për Perëndinë. Nëse vini dhe na dëgjoni ne, nëse merrni udhëzim nga ne, nëse i kushtoni vëmendje asaj që ne kemi për t’ju thënë, atëherë do ta njihni Perëndinë në një mënyrë që nuk e keni *përfytyruar* kurrë se mund ta njihnit.” Asgjë nuk ka ndryshuar këto dy mijë vjet! Bashkësitë tona përballen me të njëjtin lloj tiranie: ka njerëz që kapen pas gjërave periferike, disa prej tyre i tërheqin në studime lokale të Biblës, dhe papritur kuptoni se keni një problem me z. dhe znj.

¹⁶ Shih Romakëve 5:1.

Filan, sepse ata janë në një lloj operacioni të fshehtë, dhe kanë vendosur që të tërheqin sa më shumë dishepuj pas vetes, duke i prezantuar ata me “njohjen e vërtetë të Perëndisë.”

Çfarë do t’i ruajë anëtarët e bashkësisë sonë që të mos bien në këtë grackë? Kjo gjë arrihet kur *ne* bëjmë gjërat bazë, duke ua kujtuar atyre vazhdimisht natyrën e asaj që do të thotë të kesh një njohje të Perëndisë në Krishtin. Kur bashkësitë tona të jenë themeluar mbi këto të vërteta, nuk do të jenë më të rrezikuara nga cytjet dhe tërheqjet e heretikëve, të cilët janë kudo përreth nesh. I gjithë sigurimi i Perëndisë për ne është mbështetur mbi marrëdhënien që ai ka me ne: “fuqia e tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë.”

Këta lexues ishin të vetëdijshëm për dobësinë e tyre; ata ishin kundërshtuar nga ata që ishin të guximshëm, arrogantë dhe, me sa duket, të fuqishëm, siç do ta shihni në kapitullin 2. Prandaj, lexuesit e Pjetrit kishin nevojë për një rikujtim të fuqisë së Perëndisë. Ja pse ai thotë: “Le të mos harrojmë që ai na ka dhënë çfarë kemi *nevojë* për jetën dhe perëndishmërinë.” Ai nuk na ka dhënë gjithçka që *duam*; ai na ka dhënë gjithçka që na *nevojitet* për jetën dhe perëndishmërinë.

Ky është një rikujtim i mirë për njerëzit në bashkësitë tona, apo jo? Ata vijnë te ne të lodhur dhe të munduar; ata vijnë të mërëzitur dhe të shpërfillur; ata vijnë të zhgënjyer ose në çfarëdo gjendjeje tjetër, dhe çfarë duhet t’u themi atyre? E po, ne duhet t’i kthejmë ata te bazat: “Miku im i dashur, a e kupton që fuqia hyjnore e Perëndisë të ka dhuruar gjithçka që të nevojitet për jetën dhe perëndishmërinë? Të ka dhënë gjithçka që të nevojitet për fillimin, vazhdimin dhe përmbushjen e jetës së krishterë.” “Nuk jam i sigurt nëse mund t’ia nis.” Fuqia e tij hyjnore. “Nuk jam i sigurt nëse mund të vazhdoj.” Fuqia e tij hyjnore. “Nuk jam i sigurt nëse do të arrij dot deri në fund.” Fuqia e tij hyjnore.

Te Letra e Kolosianëve, folja që përdoret në greqisht, është *dunamoumenoi*. Do të më duhet që ta shoh se cilit vargu po i referohem tani, por kjo është në lutjen e Palit për kolosianët: “duke u rritur në njohjen e Perëndisë, duke u fuqizuar me çdo fuqi.”¹⁷ Fjala e përdorur këtu është në kohën e tashme të vazhdimësisë, që do të thotë se bëhet fjalë për atë lloj fuqie që e gjeni në ato turbinat e fuqishme aeronautike të cilat fluturojnë përtej Oqeanit Atlantik. Teksa jeni ulur mbi krahun e avionit, dhe i hidhni një vështrim turbinës, ju thoni: “A mund të vazhdojë të funksionojë kjo deri në fund? Në fakt, kjo është një mrekulli që funksionon deri në fund, apo jo? Kush do të donte të niste një fluturim nga aeroporti “Hopkins” duke ju hedhur për në Toronto, pak a shumë si të ishit një gjyle topi? Ju, pra, futeni brenda, ju vendosin një helmetë dhe pastaj ju lëshojnë. Pastaj përfundoni diku mbi Qendrën e Ekspozitës Ndërkombëtare apo në ndonjë fund tjetër të tmerrshëm. E megjithatë, ka njerëz, jeta e krishterë e të cilëve është pikërisht kështu. Ata vijnë të diel pas të diele, që pastori t’i vendosë sërish në top dhe t’i hedhë njëqind metra më tej. Si është puna me pastorin? Ai nuk po e lexon Biblën. Përndryshe, do të ishte në gjendje t’i thoshte këtij shpirti të mjerë se jeta nuk përbëhet nga periudha aktiviteti të furishëm dhe me energji, të cilat pasohen nga plogështia kronike. Përkundrazi, jeta e krishterë ka të bëjë me fuqinë e tij hyjnore që i jep drejtim fluturimit. Në të njëjtën mënyrë si ligji i aerodinamikës e mposht ligjin e rëndesës, po kështu edhe ligji i jetës së Frymës së Perëndisë brenda jetës së fëmijës së Perëndisë, është ai që e ngre lart që nga fillimi, dhe e forcon gjatë viteve të mesit të jetës dhe e përfundon punën e mirë që ai ka filluar në të. Filipianëve 1:6.

Në fakt, një nga përjetimet më zhgënjyese të fëmijërisë sime ishte kur merrja një dhuratë mëngjesin e Krishtlindjes dhe zbuloja që nuk luaja dot menjëherë me të, pasi i mungonin bateritë. Pra, kisha gjithë lodrën, por nuk kisha bateri. Kisha një tren të tërë që nuk shkonte

¹⁷ Kolosianëve 1:9–11 (parafrazim).

asgjëkund—thjesht rrinte në vend. Vagonat mund të ktheheshin kollaj në vazo lulësh. Dukej gjë e bukur për t’u parë, por nuk shkonte askund. Sigurisht, ka nga ata që kanë dukjen e perëndishmërisë, por që e mohojnë fuqinë e saj.¹⁸ Pjetri thotë se përjetimi i vërtetë i krishterë e zbulon furnizimin e Perëndisë në bashkimin dhe përbashkësinë tonë me Krishtin.

Tani do të më duhet të vazhdoj. Por, në vargun 4, ai thotë: “me anë të të cilave na u dhuruan premtimet shumë të mëdha e të çmueshme që nëpërmjet tyre të bëheni pjesëtarë të natyrës hyjnore, pasi u arratisët nga prishja që është në botë për shkak të epshit.” Të bëhemi “pjesëtarë të natyrës hyjnore”,¹⁹ apo si e thotë edhe versioni NIV: “Të merrni pjesë në natyrën hyjnore.”

Kjo është një frazë tepër e rëndësishme në kohën tonë të Epokës së Re (New Age), apo jo? Një kohë kjo kur njerëzit ende i kujtojnë komentet e asaj zonjës, sido që e kishte emrin—në filmin *Out on a Limb*. Ajo zonja... Po, Shirley MacLaine. Diçka si ai film. E keni dëgjuar idenë e “lidhjes me Perëndinë”? Në vend që të protestoni dhe të thoni: “E po, unë, në fakt, nuk bie dakord me këtë”, ju thjesht thoni: “E di çfarë? Kjo është një ide interesante, sepse dje po mendoja për këtë, kur lexova 1 dhe 2 e Pjetrit. Atje ka një frazë interesante, e cila, në fakt, e ka të gjithë idenë e lidhjes me Perëndinë, si puna e një spine që futet në prizë. Nëse keni një minutë, më lejoni që t’jua lexoj. Në fakt, këtu thuhet se fuqia hyjnore na ka dhënë gjithçka që na nevojitet për jetën dhe perëndishmërinë, dhe se mund të marrim pjesë realisht në natyrën hyjnore.” Dikush thotë: “E po, a do të thuash që të bëhemi një me hyjninë?”. “JO!” “E po, çfarë do të thuash atëherë?” Pastaj mund të shpjegoni se çfarë do të thotë të mbushesh me Frymën e Perëndisë, të bashkohesh me Birin e Perëndisë dhe të bëhesh një fëmijë i Perëndisë.

¹⁸ Shih 2 e Timoteut 3:5.

¹⁹ 2 e Pjetrit 1:4.

Në fakt, unë mendoj se në këto ditë interesi të ripërtërirë frymëror... Nuk mund ta mohojmë që ka një interes frymëror! Nuk ka shumë kohë që isha me një koleg në Klinikën e Cleveland-it këto dy javët e fundit, dhe teksa prisnim për një takim, më bëri shumë përshtypje fakti që atje po reklamonin shërim frymëror, lutje frymërore dhe *gjithçka* frymërore. Ku vajtën gjithë ata racionalistë shkencorë? Kjo është udhë pa krye. Pra, tani ata janë në kërkim të fuqisë hyjnore. E po, nëse njerëzit e krishterë nuk mund t'u tregojnë atyre për fuqinë hyjnore, kush do t'u tregojë? Mirëpo, nëse bashkësitë tona nuk janë udhëzuar në gjërat themelore, atëherë, sigurisht që ata mund të jenë thjesht duke u shpjeguar njerëzve se si Jezusi i ka bërë bashkëshortë të shkëlqyer. Mund të jenë duke shpjeguar se si kanë qëllim në jetë. Mund të shpjegojnë se si, më në fund, gjetën përmbushje. Punë e madhe! A është kjo ajo që Pali po thotë përmes këtij rikujtimi? Ato janë *përfitime*. Ato nuk janë çështja thelbësore.

T'i shtoni besimit tuaj

Besim i çmuar. Premtime të çmuara. Dhe pastaj, në vargjet 5-7—dhe ky është vendi ku shkojnë shumica prej nesh kur përballen me 2 e Pjetrit 1—ne kemi një shkallë të mrekullueshme nga besimi te dashuria. Mund të kaloni kohë, mund të shkoni te teksti greqisht dhe të thoni: “Këtu përdoret e njëjta fjalë si edhe atje”, e kështu me radhë. Zakonisht është material mjaft i mërzitshëm, thjesht për shkak të mënyrës se si e trajtojmë. Ne që mendojmë se shtjellimi është që thjesht të shkojmë te një varg dhe të qëndrojmë aty gjithë pasditen, nuk e kemi kuptuar kurrë saktësisht se çfarë mund të jetë shtjellimi. Më vonë do të themi më tepër për këtë.

Ajo që Pjetri po thotë këtu, është kjo: “Përderisa ju është dhënë kjo njohje e Perëndisë, dua që të siguroheni që kësaj t'i shtoni njohuri, e cila është dhurata e hirit të tij, atë lloj njohurie që vjen si rezultat i ushtrimit të vetes suaj.” Kjo listë e vogël, bashkë me lista të tjera në Dhiatën

e Re, sigurohet që ta godasë në kokë idenë ‘hiq dorë dhe lër Perëndinë’ të bëjë punën e tij të mrekullueshme. Edhe pse përpjekja njerëzore duket qartë që është e pamjaftueshme, ajo, megjithatë, është e pazëvendësueshme. Megjithatë, ne themi—shpresoj që të mos lëndoj askënd, edhe pse kjo do të ishte një punë shumë e vështirë gjatë këtyre ditëve që kemi përpara—por unë shkoj për të predikuar dhe dëgjoj të thuhet: “Hiq dorë dhe lër Perëndinë.” Nga çfarë të heq dorë? Të heq dorë nga rripi i pantallonave? Nga çfarë të heq dorë? Sipas Pjetrit, a është heqja dorë çelësi i pjekurisë së krishterë? Jo, çelësi është që të shtosh.

“Por ti, o njeri i Perëndisë, arratisu nga këto.”²⁰ “Ju miq në Kolos, hiqini ato rroba të vjetra dhe vishni rrobat tuaja të reja.”²¹ Sigurohuni që kur të zgjoheni në mëngjes, të mos bini pre e idesë që pasiviteti është çelësi i pjekurisë frymërore—që mënyra për t’u bërë vërtet të dobishëm për Perëndinë është që të mos bëni asgjë. Pra, që të gjeni një kolltuk të madh e të rehatshëm diku, të uleni në të, dhe e vetmja gjë që mund të kontribuoni është të qenët bezdi. Nëse mëson këtë, i bie që po mëson me kokën bosh dhe me Biblën e mbyllur. Sigurisht që këtë nuk mund ta jepni mësim nga 2 e Pjetrit 1. Ai u thotë: “[Dua që ju] duke treguar çdo zell, t’i shtoni besimit tuaj virtytin, dhe në virtyt njohurinë” e kështu me radhë.

Charles Simeon-i që njihej për jetën e tij devocionale—i cili me sa duket zgjohej shumë herët në mëngjes për të lexuar Biblën dhe për t’u lutur—edhe në vitet e fundit të jetës së tij zgjohej shumë herët në mëngjes, dhe ende vazhdonte ta lexonte Biblën dhe të lutej. Dikush i tha: “E di çfarë? Simeon, në fakt, nuk ka nevojë që ta vazhdosh këtë zakon. Ti ke ngritur një trashëgimi të jashtëzakonshme. Ti ke krijuar një kapital të jashtëzakonshëm frymëror. Ti je ngritur shumë lart. Pse nuk tërhiqesh tani? Në fund të fundit, ti tani po plakesh shumë.”

²⁰ 1 e Timoteut 6:11.

²¹ Kolosianëve 3:9–10 (parafrazim).

Përgjigjja e Simeon-it ishte kjo: “A nuk duhet të vrapoj me gjithë forcat e mia tani që e shoh vijën e përfundimit të garës?”²² Ka diçka shumë të rrezikshme për personin që thotë: “E di çfarë? Mendoj se tani e tutje do ta marr shtruar.” Pastorët që e marrin shtruar, krijojnë kisha që e marrin shtruar, dhe kishat që e marrin shtruar, shumë kollaj mund të përfundojnë në breg.

Tani do t’ju duhet të merreni vetë me këtë, sepse është koha që të lëvizim më tej. Mund ta trajtoni vetë listën. Kjo është një listë e mrekullueshme. Është një listë e dobishme. Në vargjet 5-7, Pjetri na jep gjithë këtë material për “shkallën e besimit”, nëse ju pëlqen, dhe disa kështu i janë referuar. Pastaj në vargjet 8-11, Pjetri jep disa nxitje dhe paralajmërime. Përdorimi i fjalës “nëse”, e cila sigurisht që prezantohet në tekst si përpjekje për ta kuptuar tekstin greqisht. Siç e dini, fjala “nëse” është një lidhëz, e cila prezanton një kusht, dhe çështja e realizimit apo mosrealizimit lihet e hapur. Nëse dikush ju thotë: “Përkufizojeni fjalën *nëse*”, kaq. Ajo është një lidhëz, e cila prezanton një kusht, ku çështja e realizimit ose mosrealizimit lihet e hapur. Prandaj, Pjetri u thotë: “Dëgjoni, nëse e bëni këtë, atëherë... Nëse nuk e bëni, atëherë...” Ky është një rikujtim për ne, që paralajmërimet, shtysat dhe nxitjet e Dhiatës së Re janë jetësore për përparimin tonë në besim. Sërish, nuk do të qëndroj këtu, sepse dua të arrij në fund të kapitullit në kohën që na ka mbetur.

Mirëpo, një komentues i lashtë, duke trajtuar çështjen e përforcimit të thirrjes dhe zgjedhjes suaj, për zellin që e shoqëron këtë gjë, si dhe për përpjekjen e pazëvendësueshme me anë të aftësisë nga fuqia e Perëndisë, thotë: “Margaritari i sigurisë nuk bie në prehrin e një shpirti përtac, dhe askush nuk mund të presë që ta arrijë atë... në zemrën e të cilit hiri nuk është ushtruar, dhe [mënyra e jetës] së të cilit është e pafrytshme.”²³ Njerëzit vijnë te ne dhe na thonë:

²² Charles Simeon i shkruan W. H. Michell-it, Cambridge, 28 korrik 1828, në *Memoirs of the Life of the Rev. Charles Simeon*, redaktuar nga William Carus-i (London: 1847), 620. Parafrazim. Disa detaje që lidhen me kontekstin e komenteve të Simeonit janë ndryshuar.

²³ Alexander Nisbet, *An Exposition of 1 and 2 Peter* (1658; ribotuar në Edinburg: Banner of Truth, 1982), 231.

“E po, unë nuk kam aspak siguri të besimit.” E po, pse vallë të kenë siguri të besimit, kur nuk po i shtojnë besimit të tyre? Pyetja “nëse” është një pyetje *e rëndësishme!*

Është e njëjtë me paralajmërimet e librit të Hebrenjve. “Ne jemi nga ata që vazhdojnë deri në fund dhe shpëtohen.” Kush? Ata që e marrin Fjalën dhe e zbatojnë atë. “Nuk jemi nga ata që tërhiqen pas dhe shkatërrohen. Ne jemi nga ata që vazhdojnë dhe shpëtohen.”²⁴ Nuk po themi se e shpëtojmë veten me qëndrueshmërinë tonë, por themi se qëndrueshmëria jonë është një provë e këmbënguljes së Perëndisë në jetët tona, dhe kështu na aftëson që të përparojmë.

Mendoj se këto të vërteta janë çliruese për njerëzit tanë. Ja pse ai e paraqet rrezikun e rrëzimit. Ai thotë: “Bëni mirë të keni kujdes që të mos rrëzoheni.” Ai e përdor këtë si një motiv për t’i nxitur besimtarët në zell dhe në ushtrimin e hirit. Shpresoj që asnjëri nga ne të mos e lexojë Biblën dhe të thotë: “E po, sigurisht, kjo nuk ka të bëjë fare me mua, sepse nuk ka mundësi që unë të bie.” Më fal, si the? Secili prej nesh është një hap larg rrëzimit të tmerrshëm dhe shkatërrimtar. Ne nuk i afrohem Biblës në këtë mënyrë, duke thënë: “Ky është një varg i frikshëm për disa njerëz në bashkësinë tonë.” Ky është një varg i frikshëm për *mua!*

“Përforconi thirrjen dhe zgjedhjen tuaj, sepse, duke bërë këto gjëra, nuk do të pengoheni kurrë. Sepse kështu do t’ju jepet të hyni begatisht në mbretërinë e përjetshme të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.” Nëse nuk e bëni, mund të arrini në qiell si një marinar, të cilit i është mbytur anija. Sepse unë dhe ju mund të hamendësojmë se veprat tona janë ar, argjend dhe gurë të çmuar, ama kur Dita do ta tregojë, do të zbulojmë që ato janë thjesht dru, kashtë dhe sanë, dhe ne do të shpëtohemi si përmes zjarrit.²⁵ Prandaj, ajo që Pjetri po na thotë, është: “Mos shkoni në qiell me veprat tuaja të konsumuara nga zjarri. Shkoni atje për një mikpritje të

²⁴ Hebrenjve 10:39 (parafrazim).

²⁵ Shih 1 e Korintasve 3:12–15.

mrekullueshme”, si pritja që i bëhej sportistit i cili kishte fituar garën, apo gjeneralit që kishte dalë fitimtar në betejë. Ai thotë: “Shkoni në qiell dhe do të përjetoni një mikpritje të mrekullueshme.” Sipas vargut 10, qëndrueshmëria e tanishme është: “Nuk do të pengoheni kurrë.” Kënaqësia e ardhshme paraqitet në vargun 11. Sa ditë e mrekullueshme që do të jetë ajo ditë! Perëndia nuk do të kursejë asgjë për mbërritjen dhe mikpritjen tënde.

Ky është një mendim i mahnitshëm, apo jo? Mendimi se në përjetësi, Perëndia ka qenë duke përgatitur festën e mikpritjes për ty? Dje po mendoja për faktin që një nga fëmijët e mi do të kthehet në shtëpi dhe unë nuk do të jem atje. Po mendoja për të gjitha gjërat që mund të vendosja në dhomën e saj, për t’i thënë: “Të dua dhe ti je e mirëpritur! Jam shumë i gëzuar që je kthyer në shtëpi.” Asgjë të tepruar, thjesht disa gjëra të vogla. Disa kupona për në Starbucks, që ajo të shkojë e të pijë një kafe nga unë. Ndoshta një libër. Ndoshta një foto të herës së fundit kur ishim bashkë. Ndoshta diçka që e bën të mendojë: “E di çfarë? Babai im po përgatitej për ardhjen time para se të vija unë, dhe fakti që ai nuk është këtu për të më pritur, zbutet pjesërisht nga mrekullia e shprehjes së kujdesit të tij për mua.” E po, këtë po bën Perëndia. Ati ynë është duke bërë këtë. Ai po përgatit një vend për ju.²⁶ Ai po përgatit mikpritjen tënde. Dhe në ato ditë, si në ato të hëna kur thua: “Dje ishte e diela më e keqe që kam pasur në jetën time”, kur thua me vete: “Nuk jam i sigurt nëse po e përforcoj thirrjen dhe zgjedhjen time; nuk jam i sigurt që përparoj sa mundem”, atëherë ngriji sytë lart, shiko dhe kupto që Ati është duke pritur dhe duke të përgatitur një vendbanim atje. Ai ka përgatitur një pritje të mahnitshme dhe bujare për ty.

²⁶ Shih Gjoni 14:1–4.

Tregimi i një dëshmitari okular

Nga këto nxitje dhe paralajmërime, Pjetri vazhdon në vargjet 16, 17 dhe 18 t'u kujtojë atyre që ai po u jep tregimin e një dëshmitari okular. Thjesht dua që ta përmend këtë dhe pastaj të kalojmë te pjesa e fundit.

Mënyra se si fillon vargu 16, duket se nënkupton që Pjetri po e mbron veten e tij kundër disa prej akuzave që po ngriheshin nga mësuesit e rremë: “Sepse... *nuk ndoqëm* përralla të sajara me mjeshtëri.” Disa njerëz po thoshin: “Nuk do të doje ta ndiqje atë tipin, Pjetrin. Ai thjesht i shpik gjërat. Ai i ka sajuar gjërat. Eja me ne, dhe ne do të të tregojmë shtegun e vërtetë.”

Peterson-i e parafrazoi kështu: “Ne, në fakt, nuk po shprehnim dëshirat kur ju paraqitëm faktet... në lidhje me kthimin e pushtetshëm të Zotërisë tonë, Jezu Krishtit. Ne ishim atje për parapremierën! Ne e pamë me sytë tanë.”²⁷ Kjo është sërish një parapremierë madhështore. “Ne ishim atje për parapremierën.” Çfarë po thotë Pjetri? “Ne ishim atje mbi malin e shpërfytyrimit.” Kthehuni te Luka 9 dhe lexojeni! Në fakt, ata i prishën disi gjërat kur ishin atje—por ai nuk e përmend këtë—ama ata ishin atje! “Po sikur të ngremë tri tenda këtu? Kjo është një kohë e mrekullueshme. Ndoshta mund të qëndrojmë këtu.” Jezusi u tha: “Harrojini tendat! Më shikoni mua!”. Dhe zëri nga qielli tha: “Ky është Biri im i dashur; dëgjojeni! Mjaft folët për tenda!”²⁸ (Mendoj se mund të nxjerrim ndonjë zbatim në lidhje me planet për ndërtime nga kjo pjesë, apo për diçka të ngjashme—duke mos u bazuar fare mbi faktet, por kjo nuk do t'i ndalonte shumë prej nesh. Nuk na ka ndaluar në të shkuarën dhe ndoshta nuk do të na ndalojë as tani. “Ata donin të ngrinin një tendë, por nuk duhej ta bënin, prandaj, as ne nuk duhet të ndërtojmë, e kështu me radhë.” Kjo po që është ekzegjezë e mrekullueshme.)

²⁷ 2 e Pjetrit 1:16 (MSG).

²⁸ Shih Luka 9:28–36.

Pjetri, pra, thotë: “Dua që të kuptoni se nuk jam fajtor për akuzën e spekulimit, dhe nuk jam fajtor as për akuzën e shpikjes.” Edhe Pali u përball me të njëjtën gjë, apo jo? Njerëzit po thoshin të njëjtat gjëra: “E dini çfarë? Nuk mund t’i besoni Palit.” Prandaj, kur Pali shkruan te 2 e Korintasve 4, i duhet të thotë: “Ne mohuam gjërat e turpshme që bëhen në fshehtësi, duke mos ecur në dinakëri.”²⁹ Prandaj, Pjetri thotë: “Dua që të kuptoni se mesazhi që ju kemi shpallur, bazohet mbi atë që ne kemi parë dhe dëgjuar.” Të njëjtën gjë e shihni tek apostulli Gjon: “atë që kemi dëgjuar, atë që kemi parë me sytë tanë, atë që kemi vështruar dhe që duart tona e kanë prekur.”³⁰ Ai thotë: “Ne ishim dëshmitarë okularë të shpërftyrimin dhe të ringjalljes së Zotit Jezus.” Në këtë kuptim, ata ishin dëshmitarë të “nderit dhe lavdisë” së tij, sepse, vini re, “qemë bashkë me të në malin e shenjtë”. Zëri që erdhi nga qielli atë ditë, ua drejtoi vëmendjen nga ngritja e tendave te vetë Zoti Jezus. Sepse fjala e profetëve tregonte drejt atij që ishte Mbreti mesianik dhe Shërbëtori i Përvuajtur, dhe pyetja e madhe e profetëve ishte: “Si do të bashkohen këto gjëra?”. Dhe kur Pjetri është në shtëpinë e Kornelit thotë: “Për të dëshmojnë të gjithë profetët”³¹.

Siguria e Fjalës

Pastaj, në vargjet 19-21, Pjetri kalon nga tregimi i një dëshmitari okular në rikujtimin e sigurisë së fjalës profetike. Me këtë dëshiroj që ta mbyll. Ai u thotë: “Dua t’ju rikujtoj”— rikujtoni, le t’i kthehemi asaj që kemi thënë—“Dua që t’ju rikujtoj këto gjëra; nuk kam turp që t’ju rikujtoj këto gjëra. Dua që t’ju rikujtoj për besimin e çmuar, për premtimet e çmuara, për nevojën që të vazhdoni të piqeni nga besimi në dashuri; dua që t’ju rikujtoj që t’i kushtoni

²⁹ 2 e Korintasve 4:2.

³⁰ 1 e Gjonit 1:1 (parafrazim).

³¹ Veprat 10:43.

vëmendje të veçantë nxitjeve dhe paralajmërimeve; dhe dua t’ju rikujtoj se materiali që ju kemi dhënë, është materiali i dëshmitarëve okularë. Dhe tani, si përfundim, dua që t’ju rikujtoj për sigurinë absolute të fjalës profetike. Ne e kemi edhe më të përforcuar fjalën profetike, së cilës bëni mirë t’i kushtoni kujdes.” Askush nuk mund ta keqkuptojë dot këtë. Çfarë po bën Pjetri? Ai po i kthen lexuesit e tij te Bibla! Kjo është detyra jonë.

Ka disa teza diplomash për doktoratura që qarkullojnë mbi forcën e këtyre fjalëve: “Ne e kemi edhe më të përforcuar fjalën profetike.” Disa prej jush madje mund të kenë shkruar një të tillë. Unë sigurisht që nuk e kam, dhe nuk do ta shkruaj kurrë. A po thotë Pjetri se fjala e profetëve të Dhiatës së Vjetër është bërë *më* e sigurt si rezultat i vërtetimit të saj nga shpërftyrimi i Krishtit? Apo do të thotë që Shkrimet e Dhiatës së Vjetër po konfirmojnë dëshminë apostolike? Apo që ka disa mundësi të tjera?

Çështja është që komentuesit janë të ndarë, madje edhe mënyra se si është përkthyer në versione të ndryshme të çon drejt përfundimeve të ndryshme. Çfarë bëni *ju* kur arrini në një dilemë të tillë? Unë u referohem disa njerëzve të ndryshëm dhe njëri prej tyre është Calvin-i. Sepse kur thoni: “Calvin-i tha”, ka një lloj tingulli të veçantë. Mund të thoni: “Ryrie tha”, por kjo nuk ka të njëjtën forcë—dhe kjo varet, të paktën, nga qarqet në të cilat bëni pjesë. Ju, pra, thoni: “E po, mund të jetë kjo, dhe mund të jetë kjo tjetra. Më lejoni t’ju them se çfarë tha Calvin-i.”

Calvin-i, pra, tha: “Autoriteti i Fjalës së Perëndisë është po ai që ka qenë në fillim, por pastaj u vërtetua më shumë sesa më parë nga ardhja e Krishtit.”³² Pra, i gjithë materiali profetik që tregon drejt së ardhmes, tani e ka gjetur vërtetimin e vet në Krishtin. “Ne ishim atje në shpërftyrimin e tij. Ne jemi dëshmitarë të faktit të ringjalljes së tij. E dimë që ai tani është

³² John Calvin, *The Epistle of Paul the Apostle to the Hebrews and the First and Second Epistles of St Peter*, përkthyer nga William B. Johnston, redaktuar nga David W. Torrance dhe Thomas F. Torrance, Calvin’s New Testament Commentaries 12 (Grand Rapids: Eerdmans, 1994), 340.

ngjitur në të djathtën e Atit në qiell. E gjitha kjo është vërtetim i faktit që ju mund të jeni absolutisht të sigurt për të vërtetën e asaj që po ju themi.”

Dick Lucas-i, duke komentuar për këtë varg, thotë: “Ekziston një dëshirë e natyrshme për një zë nga qielli. Ai zë është dhënë me të vërtetë... por nuk na është dhënë neve.”³³ *Ajo* fjali e shkurtër është shumë e rëndësishme, sepse vargu 18 thotë: “Dhe ne e dëgjuam këtë zë që vinte nga qielli, kur qemë bashkë me të në malin e shenjtë.” Pra, zëri nga qielli ka ardhur, ai u ka ardhur apostujve, e vërteta e apostujve tani është e shkruar për ne, prandaj nuk ka pse të presim të dëgjojmë një zë nga qielli, sepse ai zë tashmë ka ardhur, u është dhënë atyre, dhe ata tani na e kanë përcjellë neve, prandaj ne nuk e *çojmë* kurrë bashkësinë tonë përtej Biblës. Nuk na duhet *kurrë* që ta *çojmë* bashkësinë tonë përtej udhëzimit dhe praktikës apostolike. Kur anëtarët e bashkësisë sonë vijnë vërdallë duke thënë: “E di çfarë? Mendoj se dëgjova një zë nga qielli”, ose “Do të doja shumë të dëgjoja një zë nga qielli”, ne mund t’u themi: “E po, më pëlqen zelli yt. Më pëlqen fakti që je i interesuar të dëgjosh nga Perëndia, edhe mua më pëlqen shumë të dëgjoj prej tij. Mirëpo, dua që ta dish se zëri i tij është dëgjuar, dhe më lejo të të tregoj...” Ne, pra, i drejtojmë vazhdimisht njerëzit tek autoriteti dhe mjaftueshmëria e Biblës.

Nëse vazhdon në kapitullin 2—dhe sigurisht që nuk ka ndarje në kapituj—Pjetri flet menjëherë për këta individë që po bënin deklaratat të guximshme. Ata ishin plot me anekdota të sajuara dhe po mblidhnin rreth vetes njerëz të cilët ishin shumë të gatshëm që Fryma e Perëndisë t’u përcillte kërkuesve një mesazh të ri përmes këtyre tipave. Prandaj, ajo që Pjetri thotë, është kjo: përgjigjja për këtë është në sigurinë, në autoritetin dhe në mjaftueshmërinë e Shkrimit. Përgjigjja është në sigurinë, në autoritetin dhe në mjaftueshmërinë e Shkrimit.

³³ Lucas dhe Green, *2 Peter and Jude*, 23.

Si mund të bëhemi vallë të dobishëm në foltore? E po, kjo, më së shumti, ka të bëjë me bindjen që Perëndia trazon në zemrat tona në lidhje me këto gjëra: me sigurinë, me autoritetin dhe me mjaftueshmërinë e Shkrimit. Ne nuk kemi autoritet! Dua të them që, nëse kemi ndonjë dyshim, le të pyesim bashkëshortet tona. Fakti se sa shumë autoritet kam *unë*, m'u zbulua mbrëmë kur pyeta gruan: "A mund të përdorim pjata letre?". "Jo", tha ajo, "nuk mundemi." Nëse nuk do të kishte ndërhyrë dikush që kishte më shumë autoritet se unë, do të kishim ngrënë në pjata prej letre. Prandaj, unë them me vete: "A kam unë autoritet? Unë as që kam mundësi të përdor pjata letre në shtëpinë time." Ju thoni: "E po, duket që paske një grua rebele." Jo, ajo donte që të ishte një darkë e *këndshme* për ju. Ajo mendoi se ideja ime nuk vlente. Shumë prej ideve të mia janë kot.

Prandaj, nëse ajo që kemi për të ndarë para njerëzve tanë, janë vetja dhe idetë tona, dhe jo Bibla e mjaftueshme dhe me autoritet, atëherë, sinqerisht, më mirë të mbledhim plaçkat dhe të shkojmë në shtëpi. Kur e humbasim sigurinë në autoritetin, mjaftueshmërinë dhe sigurinë e këtij libri, atëherë do të sjellim në skenë valltarët, atëherë do të sjellim dritat, atëherë do të sjellim shfaqjet, pastaj do të sjellim atë tipin, burrin më të fortë në Amerikë, që i thyen me kokë shufrat e trasha të akullit. "Ejani të dielën në mbrëmje dhe shihni Pinxhon nga Minnesota, i cili do të ecë mbi litar sipër pagëzimores. Nuk do të donit që t'ju humbiste ky rast dhe të dëgjonit dëshminë e tij të mrekullueshme, se si erdhi te Jezusi!" Po, mirë, pra, shkoni në shtëpi të gjithë; paçi një pasdite të këndshme dhe mos u dukni! Një tragjedi e tillë është kudo rreth nesh.

Mungesa e Biblës në krishterimin ungjillor tani është një epidemi dhe fenomen i frikshëm, por jo për ata që nuk po e lexojnë dhe as po e predikojnë atë. Ka të ngjarë që jemi një brez larg nga shkatërrimi i Evropës Perëndimore, nëse Perëndia nuk vjen që të ndërhyjë me Frymën e tij. Dhe për këdo që shkon dhe sheh kishat e mia të vjetra në Skoci, dhe thotë: "Si ka

mundësi që arritet në këtë pikë?”, përgjigjja ime është gjithmonë e njëjta: “Prit. Do ta zbulosh, sepse ju po na ndiqni nga pas.” Humbja e sigurisë në fjalën profetike, që është vërtetuar edhe më tepër, qëndron në zemër të shkatërrimit dhe të humbjes së atij lloji krishterimi të gjallë për të cilin Pjetri po i kujtonte miqtë e tij të dashur në këtë letër.

Ka grupe të rinjsh të cilëve u thuhet të mos i marrin Biblat me vete, sepse do të jetë një mbrëmje ungjillzuese. Çfarë po planifikoni t’u thoni këtyre paganëve kur të vijnë? Mos vallë e keni mësuar përmendsh të gjithë Biblën? Dua të them, mos vallë e ditkeni Biblën fjalë për fjalë? “Jo.” E po, çfarë do t’u thoni atyre kur t’ju bëjnë një pyetje? Ku po shkoni? “Oh, ne nuk e bëjmë atë! Jo, nuk e bëjmë atë.” E po, *bëjeni!* Sepse zbulimi i Fjalës së Perëndisë jep dritë.³⁴ Takimet rrallëherë i referohen Biblës. Në shumë qarqe, thirrja për t’i rikujtuar fjalët që janë thënë në të shkuarën—që është vargu 3:2, dua “që të mbani mend fjalët që u thanë më parë”—është zëvendësuar nga një thirrje për t’i kushtuar vëmendje fjalës profetike që po flitet në të tashmen. Rezultati i kësaj është që, shumë lehtë, humbasim sigurinë apo interesin për Biblën.

Pra, detyra e pastorit është që të sigurohet që bashkësia e tij të jetë e ankoruar te Fjala e Perëndisë dhe e themeluar në veprën e Krishtit. E shihni që profetët nuk kishin dalë thjesht të bënin më të mirën që kishin mundësi, duke qenë të rrezikuar nga njerëz më të zgjuar që do të vinin pas tyre. Nuk do të ketë më kurrë një dritë hyjnore përmes së cilës njerëzit do të udhëhiqen, përveçse me anë të Shkrimeve. Më në fund, do të agojë dita kur zbulesa e jashtme dhe ndriçimi i brendshëm do të kombinohen, dhe atëherë do të njohim plotësisht, ashtu sikurse edhe njihemi. Kjo është përpjekja ime më e mirë për t’ju shpjeguar fundin e vargut 19: “derisa të zbardhë dita dhe ylli i mëngjesit të lindë në zemrat tuaja.” Bëni diçka me *atë!* Shumica e shpjegimeve nuk më pëlqejnë. Ndoshta për shkak se nuk jam shumë i mprehtë. Ama ato shpjegime duken si të

³⁴ Shih Psalmi 119:130.

sforcuara. Më duket sikur ajo që Pjetri po thotë, me njëfarë imazhi i cili ndoshta ishte më i kuptueshëm për shekullin e parë sesa për shekullin e njëzetë, tingëllon pak a shumë si 1 e Korintasve 13: “Sepse tani, ne shohim si në pasqyrë, në mënyrë të errët, por atëherë do të shohim faqe për faqe; tashti njoh pjesërisht, kurse atëherë do të njoh thellë, ashtu sikurse njihem.”³⁵ Kështu, zbulesa e jashtme do të kombinohet me ndriçimin e brendshëm dhe krejt papritur do të shohim një panoramë të madhe zbulimi. Ai thotë: “Ajo ditë po vjen. Por ajo ditë nuk ka ardhur ende. Pandaj, ndërkohë, për t’ju mbajtur në shtegun e duhur, bëni mirë të qëndroni në Biblën tuaj. Profecia nuk erdhi nga vullneti i njerëzve.” Me fjalë të tjera, Shkrimet nuk janë produkt i mençurisë personale të vetë profetëve.

Vëllezër, ne duhet t’ia kujtojmë vetes këtë gjë. Nëse lexoni studime kritike, studiuesit kritikë thonë: “E po, pse t’i kushtoni vëmendje Isaias? Çfarë dinte vallë Isaia për shekullin e 21-të? Ai jetoi shumë kohë më parë. E pranojmë që ishte burrë i mirë, por ju e dini që atij ia kanë kaluar të tjerët. Ka shumë kohë që kurse ndodhi kjo.” Nëse ajo që kemi në profetët e Dhiatës së Vjetër, do të ishin thjesht idetë e tyre personale, atëherë mund t’i shihnim fjalët e tyre si të kufizuara nga gabueshmëria njerëzore dhe nga pikëpamja e tyre për botën, dhe në këtë rast mund të ishim në gjendje ta hidhnim poshtë atë që ishte shkruar, duke u mbështetur te idetë e reja të së sotmes. Sërish, më lejoni që t’ju citoj nga miku im, Dick Lucas: “Profeti i Dhiatës së Vjetër nuk doli vullnetar për të kontribuar me idetë dhe udhëzimet e tij, dhe pastaj të korrigjohej nga një pasardhës më i shkolluar!... Fjala profetike mbetet përgjithmonë Fjala e Perëndisë.” Kur lexojmë Isaian, “nuk po na flet thjesht një burrë [i lashtë], por... vetë Perëndia.”³⁶ *Perëndia* flet. Prandaj, kur Fjala e tij shpallet me besnikëri, zëri i tij dëgjohet me të vërtetë.

³⁵ 1 e Korintasve 13:12 (parafrazim).

³⁶ Lucas dhe Green, 2 *Peter and Jude*, 23.

Ata u morën—njerëz realë në një situatë reale—velat i kishin të ngritura, nëse mund ta themi kështu, dhe u shtynë nga Fryma e Shenjtë në drejtimin e zgjedhur nga Perëndia, për të përmbushur qëllimin e Perëndisë. Burra realë nga sfone të ndryshme—jo robotë, jo daktilografë, jo sekretarë—të fuqizuar nga veprimtaria e Frymës së Shenjtë, ndërsa Perëndia e zbulon veten e tij përmes tyre.

Sërish, Calvin-i thotë: këta burra “nuk guxuan të bënin asgjë nga vetja, por vepruan vetëm në bindje ndaj udhëzimit së Frymës, i cili kishte kontroll mbi buzët e tyre si në tempullin e Tij.”³⁷ Isaac Watts-i thotë:

Qiejt tregojnë lavdinë tënde, Zot,
Shkëlqen urtësia jote në çdo yll;
Por kur Fjalën tënde ne shikojmë,
Më qartë emrin tënd e lexojmë.

Këtu shohim të tuat të ndritura mrekulli,
Kur fal mëkatet dhe shpirtrat përtërin.
Zot, më pastro, më përtëri,
Me Fjalën tënde në qiell më pri!³⁸

Vëllezërit e mi të dashur, nëse kjo bëhet bindja e sinqertë e zemrave tona, atëherë, kjo do të na *fuqizojë* për detyrën që na pret. Duke qenë se tani kemi një siguri të jashtëzakonshme—jo në veten tonë, por në fuqinë e Frymës, përmes së cilit ai na ka dhënë gjithçka që na nevojitet për jetën dhe perëndishmërinë.

Le të lutemi bashkë:

Ç’themel i fortë për ju, shenjtorë të Zotit,
Është hedhur për besimin tuaj në Fjalën e tij të përsosur!
Çfarë tjetër mund t’ju thotë, përveç asaj që ju ka thënë,
Juve që në Jezusin keni shkuar të strehoheni?³⁹

³⁷ Calvin, *Hebrews and First and Second Peter*, 344.

³⁸ Isaac Watts, “The Heavens Declare Thy Glory” (1719). Fjalët janë ndryshuar pak.

³⁹ “How Firm a Foundation” (1787). Fjalët janë ndryshuar pak.

Atë, të lutem që njohja që kemi për këto gjëra, të mos na pengojë për të bërë një vetëshqyrtim të sinqertë, që, duke kaluar, më së pari, vetë nën hetimin e Fjalës sate, të jemi më pas në gjendje të flasim si njerëz të fuqizuar nga fuqia e Frymës sate dhe nga autoriteti i Fjalës sate.

Të falënderojmë për këtë kohë; të falënderojmë për njëri-tjetrin dhe të lutemi që ti ta bekosh kohën tonë së bashku, në mënyra të cilat as që i kemi pritur ndonjëherë, sepse ti bën shumë më tepër nga sa ne mund të kërkojmë apo të mendojmë.⁴⁰ Kjo gjë na jep siguri. T'i dorëzojmë ty familjet e kishës sonë, shqetësimet tona, të afërmit tanë, nën kujdesin dhe ruajtjen tënde, nëpërmjet Zotit tonë Jezu Krisht. Amen.

⁴⁰ Shih Efesianëve 3:20.